REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 4 maj 2020
Nr. Ref.:RK 1554/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI14/20

Parashtrues

Armend Thaqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 425/2019, të 10 dhjetorit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Armend Thaqi, me vendbanim në fshatin Balincë, Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson Ekrem Agushi, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Rev. nr. 425/2019, të 10 dhjetorit 2019, me të cilin ishte refuzuar si i pabazuar revizioni i tij kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), Ac. nr. 2630/19, të 24 korrikut 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 janar 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 23 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

7. Më 29 janar 2020, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin që dëshmon që ai e përfaqëson parashtruesin e kërkesës para Gjykatës.

8. Më 4 shkurt 2020, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës autorizimin e kërkuar.

9. Më 5 shkurt 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 15 prill 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 15 tetor 2011, parashtruesit të kërkesës i kishte ndodhur një aksident në objektin e Kompanisë "I" në Ferizaj (ku kishte shkuar për të blerë auto-goma) me ç'rast pretendohet se ai kishte pësuar lëndime trupore. Parashtruesi i kërkesës pretendon se lëndimi i tij në hapësirat e kompanisë "I" kishte ndodhur si pasojë e mos ndërmarrjes së masave përkatëse të sigurisë brenda objektit afarist, nga kompania në fjalë.

12. Më 26 prill 2012, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi kundër Kompanisë "I" në Gjykatën Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), për kompensim të dëmit të shkaktuar si pasojë e aksidentit të lartcekur.

13. Më 21 mars 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit C.nr.795/15, vendosi se padia e parashtruesit të kërkesës konsiderohet e tërhequr pasi që as parashtruesi i kërkesës (në cilësi të paditësit) dhe as përfaqësuesi i tij, megjithëse ishin njoftuar në mënyrë të rregullt, nuk kishin marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor lidhur me padinë (të 21 marsit 2019, në ora 9:00) dhe nuk e kishin arsyetuar mungesën e tyre.

14. Më 26 mars 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës kishte bërë propozim në Gjykatën Themelore për kthim në gjendjen e mëparshme, me arsyetimin se në të njëjtën ditë kur ishte caktuar seanca në Gjykatën Themelore kishte qenë i ftuar edhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan lidhur me një lëndë tjetër, si dhe, se ai gjithashtu ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore. Andaj, ai kërkoi nga Gjykata Themelore, që të evitojë pasojat e dëmshme si rezultat i shpalljes së padisë së tij të tërhequr dhe t'i bëjë të mundur *"realizimin e të drejtës për një Gjykim të drejtë dhe ligjor"* të garantuar me KEDNJ.

15. Më 27 mars 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit C.nr.795/15, refuzoi propozimin për kthim në gjendje të mëparshme me arsyetimin se ishin plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme. Kjo Gjykatë arsyetoi se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, megjithëse kishte njohuri lidhur me seancën që do të mbahej në të njëjtën kohë në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, nuk e kishte njoftuar Gjykatën Themelore në Ferizaj se ai do të mungonte në seancën e 21 marsit 2019 edhe pse kishte kohë të mjaftueshme për ta bërë këtë. Ndërsa, lidhur me dëshminë mjekësore të paraqitur nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës se ai ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore, Gjykata Themelore kishte theksuar se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ishte paraqitur po atë ditë në Gjykatën Themelore në Ferizaj në ora 13:00. Aty kishte pyetur nëse do të mbahej seanca e caktuar në orën 9:00 dhe kishte deklaruar se ai atë ditë kishte pasur një seancë tjetër në Gjykatën Themelore në Prishtinë –dega në Lipjan dhe se nuk kishte theksuar se kishte qenë te mjeku.

16. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës u ankua në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore C.nr.795/15, të 27 marsit 2019, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, duke pretenduar

se Gjykata Themelore nuk ka vlerësuar si duhet arsyeshmërinë e mungesës së tij në seancën shqyrtuese të 21 marsit 2019.

17. Më 24 korrik 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit Ac.nr.2630/19, e refuzoi ankesën e paraqitur nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës si të pathemeltë dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore C.nr.795/15, duke mbështetur arsyetimin e Gjykatës Themelore.

18. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.2630/19, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

19. Më 10 dhjetor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit Rev. nr.425/2019, refuzoi si të pabazuar revizionin, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.2630/19.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar, Gjykata Supreme ka bërë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ.

21. Parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij lidhur me shkeljet e të drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, si dhe të drejtës për mbrojtje gjyqësorë të të drejtave të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, i ndërlidh me shkeljet e dispozitave ligjore të procedurës kontestimore nga gjykatat e rregullta. Sipas parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta ia kanë shkelur të drejtat kushtetuese në fjalë kur kanë vendosur lidhur me të drejtën e parashtruesit për kthimin në gjendjen e mëparshme, lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Themelore C.nr.795/15 të 21 marsit 2019, me të cilin padia e parashtruesit të kërkesës është konsideruar e tërhequr pasi përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës nuk kishte marrë pjesë në seancën shqyrtuese të 21 marsit 2019.

22. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se ka ofruar prova të mjaftueshme për shkaqet që kanë ndikuar që përfaqësuesi i tij të mos mund të marrë pjesë në seancën shqyrtuese të 21 mars 2019, në Gjykatën Themelore, duke theksuar se të njëjtën ditë kishte qenë i ftuar edhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, lidhur me një lëndë tjetër si dhe se ai gjithashtu ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore, e cila mund të verifikohet me dëshmi të mjekut. Ai thekson se këto shkaqe nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Themelore edhe pse kjo mungesë nuk ka mundur të evitohet nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës. Andaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore ka zbatuar gabimisht dispozitat e nenit 423 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me këtë veprim jo të ligjshëm ka shkelur të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm.

23. Parashtruesi argumenton më tej se *"nga vërtetimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan si dhe raporti mjekësor i dt.20.03.2019 vërtetohet se me dt. 21.03.1019 [përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës] në gjendje shëndetësore të konstatuar në raportin mjekësor është paraqit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega ne Lipjan, në seancën e dt.21.03.2019 në ora 10 lidhur me lëndën civile, C.nr.552/17 [...], vetëm sa për të dëshmuar pamundësinë subjektive për të marrë pjesë në seancë, mirëpo kjo seancë e caktuar nga gjykatësja e çështjes nuk është mbajt [...] dhe pastaj në një gjendje të njëjtë shëndetësore i autorizuari i paditësit i ndihmuar dhe shoqëruar nga avokati A.H. [...], (i cili e ka drejtuar auto veturën e tij personale prej Lipjanit për në Ferizaj) është nisur për tu paraqitur në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me ç'rast është paraqitur ne zyrën e gjykatësit M.F. për të njoftuar dhe justifikuar mungesën e paraqitjes në seancën të dt.21.03.20119 ne ora 9:00."*

24. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, në vendimet e tyre, kanë paraqitur interpretime te gabuara juridike dhe se ekzistojnë kundërthënie mes arsyeve të paraqitura dhe përmbajtjes së dokumenteve (raportin mjekësor), të cilat i janë bashkangjitur kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme dhe të cilat gabime nuk i ka evituar as Gjykata Supreme. Ai po ashtu pretendon se të gjitha këto shkelje janë rrjedhojë e veprimeve të njëpasnjëshme dhe shumë të dëmshme për parashtruesin e kërkesës *"nga gjykatësi [M.F.] i cili ka krijuar praktik shumë të gabuar dhe të dëmshme për palët duke nxjerrë vendime të tilla gjyqësore"* me të cilat shkelen dispozitat e nenit 6 të KEDNJ.

25. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ, ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 425/2019 të 10 dhjetorit 2019, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2630/2019 të 24 korrikut 2019, Aktvendimin C.nr.795/15 të Gjykatës Themelore të 21 marsit 2019 dhe Aktvendimin C.nr.795/15 të Gjykatës Themelore të 27 marsit 2019, *"ti prish dhe çështjen ta kthej në rigjykim"*.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

"Neni 129

129.1 Ne qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.
[...]

Neni 423

[...]
423.3 Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit.
[...]."

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

28. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

Neni 49
[Afati]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]."

29. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; ka qartësuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston dhe të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar; si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor.

30. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

31. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, gjegjësisht të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe të drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës.

32. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës ankohet se gjykatat e rregullta nuk kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozita ligjore lidhur me të drejtën për kthim në gjendje të mëparshme, përkundër faktit që ai ka ofruar prova të mjaftueshme për të dëshmuar pamundësinë e pjesëmarrjes së përfaqësuesit të tij në seancën e 21 marsit 2019, ku shqyrtohej padia e parashtruesit.

33. Gjykata vlerëson se edhe përkundër faktit që parashtruesi i kërkesës thirret në shkeljet e të drejtave të tij kushtetuese, në thelb ai ngrit çështje të zbatimit të ligjit. Kjo, në ndërlidhje me vlerësimin nëse janë plotësuar kriteret e parapara ligjore për kthimin ne gjendje të mëparshme, si rezultat i pamundësisë së përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës që të marrë pjesë në seancën shqyrtuese lidhur me padinë e tij, me ç'rast Gjykata Themelore kishte konsideruar padinë e tij të tërhequr.

34. Lidhur me këto pretendime, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Themelore, përmes Aktvendimit C.nr.795/15 të 27 marsit 2019:

"Gjykata [Themelore] pas shqyrtimit të parashtresës së [përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës] se ka pasur seancë [...] edhe në Gjykatën Themelore në Prishtine Dega Lipjan, [...] për date 21.03.2019 ne ora 9.00 [...] ka ardhur në përfundim se kjo provë, nuk është e bazuar nga se flete dërgesa e Gjykatës Themelore ne Prishtine Dega Lipjan, është ekspeduar me datë 14.02.2019, ndërsa ftesën nga ana e Gjykatës Themelore ne Ferizaj përfaqësuesi i [parashtruesit të kërkesës] e ka pranuar më datë 08.02.2019

d.m.th. 6 dite para se ta pranoj ftesën nga ana e Gjykatës së Lipjanit, dhe kjo nuk e arsyeton mos prezencën e përfaqësuesit të [parashtruesit të kërkesës] në seancën e treguar në Gjykatën Themelore ne Ferizaj duke pasur parasysh [që] ftesën e ka pranuar me herët nga Gjykata Themelore e Ferizaj dhe i njëjti ka pasur kohë të mjaftueshme që ta lajmëroj Gjykatën [Themelore] me shkrim për mungesën e tij.

Gjykata [Themelore] e ka shqyrtuar edhe vërtetimin e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtine- Dega ne Lipjan me të cilën janë njoftuar palët se seanca e datës 21.03.2019 nuk mbahen nuk janë prove me të cilën përfaqësuesi i [parashtruesit të kërkesës] mundet ta arsyetoj mungesën e tij për seancën e treguar ne Ferizaj.

Sa i përket raportit mjekësor të cilën e ka sjell përfaqësuesi i [parashtruesi të kërkesës] nuk mjafton që ta arsyeton mungesën e tij për mos prezencë në shqyrtimit kryesor të treguar me datë 21.03.2019 nga ana e Gjykatës Themelore ne Ferizaj, përfaqësuesi i [parashtruesit të kërkesës] po të njëjtën dite në ora 13:00 është lajmëruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe ka pyetur se a do të mbahet seanca e cila ka qenë e treguar për ora 9.00, me arsyetim se ka qenë i angazhuar në Gjykatën e Lipjani ne ora 9.00. Përfaqësuesi i [parashtruesit të kërkesës] nuk ka theksuar fare se ka qenë te mjeku për shkaqe shëndetësore."

35. Gjithashtu, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në tërësi kanë pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të Gjykatës Themelore, duke vlerësuar se ajo drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë i ka zbatuar dispozitat ligjore, kur ka refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme.

36. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë vlerësuar faktet dhe kanë interpretuar dhe zbatuar dispozitat ligjore në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Përfundimet e tyre u arritën pas shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës.

37. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit para Gjykatës të njëjtat argumente që kishte parashtruar në procedurat pranë gjykatave të rregullta, në veçanti lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të rregullta.

38. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI129/19, parashtruesi i kërkesës: *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 55; shih gjithashtu rastin KI40/17, parashtrues *Muharrem Bytyqi dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 korrikut 2017, paragrafi 35).

39. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI129/19, parashtruesi i kërkesës: *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 56 dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012, paragrafi 33).

40. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI129/19, parashtruesi i kërkesës: *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 57 dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42; shih gjithashtu, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

41. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë, sipas nenin 31 të Kushtetutës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI129/19, parashtruesi i kërkesës: *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 58; shih gjithashtu, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992 dhe rastin e GJEDNJ, *Shub kundër Lituanisë*, Aktgjykimi i 30 qershorit 2009).

42. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta, veçanërisht Gjykata Themelore, kur i referohen pretendimeve të parashtruesit për shkelje të ligjit, dhe vlerësimit të pretendimeve të tij lidhur me arsyeshmërinë e mungesës së tij në seancën shqyrtuese të 21 marsit 2019, është i qartë dhe i mjaftueshëm dhe se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis,* rastin e Gjykatës Kushtetuese KI129/19, parashtruesi i kërkesës: *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 59; shih gjithashtu, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ, *Shub kundër Lituanisë*, Aktgjykimi i 30 qershorit 2009).

43. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjykatat e rregullta i kishin shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës.

44. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* dhe as nuk e ka mbështetur pretendimin që tregon se si dhe pse e drejta për mbrojte gjyqësore të të drejtave, e garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, është shkelur.

45. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta, në ndonjë mënyrë, kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tij kushtetuese.

46. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 15 prill 2020, njëzëri

VENDOS

I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi